



Prishtinë: 27.08.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1280\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2061\_06\_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **16.07.2020**.

### në seancën e mbajtur më datë 27.08.2020 nxori këtë:

#### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin S.M. nga Komuna e Prizrenit, me shifer të konsumatorit DPZ 14047, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2061\_06\_20, i datës 10.06.2020.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 16.07.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, ndaj konsumatorit S.M. nga Komuna e Prizrenit, lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues nr.50600DPZ – 14047 të datës 29.06.2017, për këto shkaqe: se analiza e rrjedhës së energjisë elektrike nuk mund ta vërtetoj përqindjen e gabimit në matje dhe se është jo logjike të merret për bazë fakti që konsumatori ka luhatur të shpenzimit në periudhën e matjes me njehsorin e ri, por që sipas raportit të qëndrës së kalibrimit është konstatuar se njehsori nuk ka bërë matje në fazën R dhe T dhe gabim në matje nuk mund të konstatohet sipas shpenzimit vijues.

KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2061\_06\_20 i datës 10.06.2020 për konsumatorin S.M. me shifwr DPZ- 14047.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO në të cilën pretendohet që analiza e rrjedhës së energjisë elektrike nuk mund ta vërtetoj përqindjen e gabimit në matje dhe se konstatimi nga qendra e kalibrimit se njehsori nuk ka bërë matje në fazën R dhe T është provë e mjaftueshme se njehsori nuk ka bërë regjistrimin e shpenzimit të tërësishëm, Bordi i ZRrE thekson se, bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe me njehsorin e ri, konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Sipas analizës të të dy njehsorëve, për



periudha të njëjta kohore, Bordi i ZRrE ka konstatuar se ka ndryshim të shpenzimeve. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike, mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik **nr.34887517** është si në vijim:

- Për periudhën 11/2015 – 04/2016 është 452 kWh/muaj;
- Për periudhën 11/2016 – 04/2017 është 530 kWh/muaj,

Kurse me njehsorin e ri elektrike **nr. 67789952**, mesatarja e shpenzimeve mujore është si në vijim:

- Për periudhën 11/2017 – 04/2018 është 719 kWh/muaj;
- Për periudhën 11/2018 – 04/2019 është 571 kWh/muaj.

Bazuar në krahasimet e bëra, Bordi i ZRrE konstaton se konsumatori ka ndryshim në shpenzimet e regjistruara me dy njehsorët elektrik, përkatësisht ka luhatje të shpenzimit të energjisë elektrike të cilat nuk vërtetojnë se njehsori i parë nuk ka bërë matje të saktë, e një gjë e tillë lehtësisht mund të vërtetohet nga rrjedha e energjisë elektrike, pasi në periudha të ndryshme ka luhatje të shpenzimit.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit se punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë konstatuar se njehsori ka të djegur sistemin e fazës R dhe T, dhe si pasojë e kësaj njehsori ka regjistruar energji elektrike për 66.66% më pak dhe se është jo logjike që për faturim plotësues të merret mesatarja e shpenzimit me njehsor të ri duke e zbritur faturimin, Bordi i ZRrE ka konstatuar se, KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi, sipas të cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës, atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë rillogaritjen e energjisë. Por që, KESCO nuk e ka respektuar nenin 4.11.2 të Kodit të Matjes së OSSh-së, në të cilin në mënyrë decisive thuhet se: *“Në rastin kur konstatohet se njehsori ka gabuar 100%, nuk ka regjistruar fare, atëherë korrigjimi i energjisë elektrike do të bëhet sipas mesatares paraprahe të shpenzimit të konsumatorit, gjithashtu te rastet e defektit të ndonjë sistemi matës (pa ndonjë ndërhyrje të qëllimshme) veprohet me mesatare duke zbritur shpenzimin e regjistruar dhe faturuar”*. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, ZRrE ka konstatuar se faturimi i konsumatorit për periudhën 11/2016 deri në periudhën 04/2017 duhet të bëhet me mesataren e vitit vijues për periudhën e njëjtë, duke zbritur shpenzimin e regjistruar dhe faturuar në periudhën kontestuese. Mesatarja e shpenzimeve për periudhën vijuese 11/2017 deri në periudhën 04/2018 është 719 kWh/muaj, kurse në periudhën kontestuese është 530 kWh/muaj, e që rrjedhimisht i bie që konsumatori duhet të faturohet 189 kWh për muaj. Pra Bordi i ZRRE konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë të ZRRE (DMK), ku është obliguar KESCO që konsumatorin me shifër DPZ- 14047 t'i anulojë korrigjimin plotësues nr.50666DPZ-14047 të datës 29.06.2017 në vlerë financiare 431.61€ € dhe ka kërkuar që konsumatorit me shifër DPZ- 14047 t'ia korrigjoj faturat e periudhës 11/2016 - 04/2017 duke ngarkuar konsumatorin me 189 kWh për muaj, është vendim i drejtë, i ligjshëm dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit S.M. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.